



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Datë: 25.06.2026

PROCES-VERBAL

Këshilli Bashkaik Kamëz i mbledhur sot, në dt. 25.06.2026, në orën 16:00, në mbledhjen e radhës të muajit Prill 2026 në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kamëz. Të pranishëm në mbledhje janë 22 anëtar të Këshillit, përfaqësues nga administrata e Bashkisë. Mbledhja mbahet nga Kryetari i Këshilli Bashkiak z.Hysen Koldashi i cili hap mbledhjen me fjalët përshëndetëse.

Kr. Hysen Koldashi: Sipas njoftimit nga sekretaria mbi bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në rregulloren e Këshillit Bashkiak 33 datë 21.03.2024; Neni 81 pika 1, sot zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak.

Kr. Hysen Koldashi: Përpara se ta fillojmë, i kalojmë fjalën sekretarisë për prezencën. Ju lutem, sekretaria.

- Sekretaria konfirmon pjesëmarrjen e Këshilltarëve.

Kr. Hysen Koldashi:Paraprakisht hedhim në votim proces-verbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. E hedhim në votim. 22 vota-Pro, 0 vota -Kundra, 0 vota -Abstenim.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit! Atëherë, me rendin e ditës jeni njohur, e keni të printuar në tavolinën tuaj, si më poshtë vijon:

1. **Projekt-Vendim Nr. 45 datë 23. 06.2026 për: “Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Znj.Vitore Ndoci”.**
2. **Projekt-Vendim Nr.40 datë 18.06.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.**
3. **Projekt-Vendim Nr.41 datë 19.06.2026 për: Miratimin e projektbuxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën 2027-2028-2029”.**
4. **Projekt-Vendim Nr.42 datë 19.06.2026 për: “ Miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Kamëz”.**
5. **Projekt-Vendim Nr.43 datë 23.06.2026 për: “Emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë Kmëz”.**
6. **Projekt-Vendim Nr.44 datë 23.06.2026 për: “Emërtimin e stadiumit në Lagjen Administrative Nr.1”.**
7. **Të ndryshme.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Kr. Hysen Koldashi: Sipas rendit të ditës, në pikën 1 (një) kemi të bëjmë me betimin e një anëtarit të ri të Këshillit Bashkiak Znj. Vitore Ndoci, dhe e kemi prezente në mbledhje. E nderuar Znj. Ndoci unë do të lexoj formulën e betimit dhe ju do të thoni betohem.

“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t'i bindem kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjitha anëtarësit e mi do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Kamëz dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Vitore Ndoci: Betohem.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Ta gëzosh mandatin e anëtarit të Këshillit Bashkiak.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës nr.41 datë 19.06.2006, për: “Miratimin e projektbuxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën 2027-2029. Për projektvendimin që sapo lexova nga këshilltarët ka kush pyetje, pa qartësi, mund të bëni pyetje për drejtoreshën, e kemi prezente. Atëherë, ta bëj dr. një shpjegim të shkurtër.

Vjollca Smaçi: Drejtor i Financës Përshëndetje të gjithëve. PBA-në për periudhën 2027-2029, në këtë moment që e kemi paraqitur në Këshill, është faza e parë e miratimit të përbashkët 2027-2029 dhe buxhetit që do të vijë në vitin 2027. Këtij projektvendimi i është paraprirë me miratimin e limiteve të përbashkët, që është bërë në, mos gaboj, dy mbledhje para kësaj periudhe. Programi buxhetor afatmesëm është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar dhe disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve të financimit publik dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Ky program, PBA-ja aktualisht po bëhet gati 3 vite, monitorohet në kohë reale nga Ministria e Financave. Ky projektbuxhet, PBA-ja 2027-2029, është dërguar dhe në Ministrinë e Financave nëpërmjet sistemit informatik SMPV dhe deri në këtë moment nuk kemi marrë asnjë vërejtje, asnjë koment nga MF për hartimin e këtij projekti buxheti afatmesëm. Ky projektbuxhet afatmesëm, megjithëse është në nivel programi, në pjesën më të madhe, sidomos për investimet, në qoftë se shikoni tabelat e bashkisë, të gjitha investimet janë parashikuar në mënyrë analitike sipas programeve buxhetore dhe sipas kodeve të produkteve për secilin projekt, janë ndarë në mënyrë të detajuar, është parashikuar në mënyrë të detajuar, realizimi i planit të ardhurave sipas drejtorive dhe sipas llojit të taksave dhe tarifave vendore. Njëkohësisht, e njëjta gjë është bërë dhe për shpenzimet, si për shpenzimet për paga, për sigurime shoqërore, shpenzimet operative, shpenzimet për ndihma e të tjerë. Dua të them një shifër që është me të vërtetë shumë e kënaqshme edhe për periudhën që ka kaluar, edhe për këtë projektbuxhet. Themi që në këtë buxhet parashikimi i shpenzimeve që do të realizohen pasi të miratohet ky projektbuxhet zë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

rreth, ose më saktë mbi 40% të totalit, të të gjithë këtij buxheti. Është një shifër mjaft e kënaqshme, duke parë dhe të gjithë këto shpenzime. Shpenzimet më të mëdha, shkojnë për kopshtet, çerdhet. duhet të theksojmë kopshtet e çerdhet, pasi është rritur ndjeshëm numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet. Për këtë është miratuar një fond në mënyrë analitike për çdo program dhe njëherë për shkollat në vete, për kopshtet në vete, për çerdhet në vete dhe për ndërmarrjet e varësisë është miratuar buxheti më vete. Edhe diçka të fundit, një pjesë e mirë e këtij projektbuxheti është miratuar edhe për fondin social për shtresat në nevojë. Kjo është një gjë që ka pasur një impakt mjaft të mirë për shtresat në nevojë, pasi këtu kemi dhe Dr.e NE e cila për çdo muaj i paraqit rastet për ndihma ekonomike .

Kr. Hysen Koldashi: Po, faleminderit, këshilltar fjala për ju. Kush ka pyetje-diskutime?

Alfred Halilaj Këshilltar merr fjalën: Përshëndetje. Në fakt nuk e kisha në plan të flisja, vetëm do jepja votën kundër e ta mbyllja, por megjithatë drejtoresha e mori fjalën për të bërë shpjegime. Meqë ju thoni që e monitoroni vazhdimisht PBA-në, ne kemi miratuar disa PBA-ja, ju se unë s'kam miratuar asnjë, dhe a bëni ju ndryshime gjatë PBA-ve të cilat ne i kemi miratuar dhe më pas ju nuk i keni zbatuar? Psh. do marr vetëm rrugën "Teuta", që nga dy herë deri tani e kemi kaluar PBA dhe juve nuk keni bërë asnjë investim në atë rrugë, pra e keni devijuar herë pas here. E dyta, po të shikosh tabelat me kujdes, kur vjen te viti 2029, ka njëfarë rënie. Nuk e di çfarë parashikoni ju në 2029. Një element tjetër, ju thoni për shpenzimet, po si ka mundësi që shpenzimet operative ju rriten vazhdimisht, ndërkohë që shërbimet nuk rriten në këtë bashki, ndërkohë që po shkojmë vazhdimisht drejt shërbimeve online dhe po e reklamojmë me të madhe shërbimet online?

Vjollca Smaçi Drejtore e Financës : A mund ta shpjegoj? Atëherë, në lidhje me parashikimin e rrugëve, rrugët gjithmonë parashikohen nga drejtoria e projekteve dhe investimeve në blloqe të mëdha dhe ato kanë rrugët përkatëse. Në qoftë se ju i shikoni disa herë, po them sepse mund të më kujtohet tani këtë që thoni ju, rruga Teuta, atëherë kjo rrugë mund të është parashikuar për vitin tjetër, sepse gjithmonë këto janë PBA për 3 vite. E ke lexuar vitin e kaluar, normal do e lexosh edhe këtë vit, do e lexosh dhe vitin tjetër. Po, sepse është parashikuar për 3 vite, prandaj është PBA dhe shpenzimet në asnjë mënyrë nuk janë rritur. Janë rritur shërbimet ndaj komunitetit. Shumë shërbime të cilat aktualisht ndërmarrja e shërbimeve publike, shumë shërbime nuk i kryen me tendra, për kursim fondesh i kryen me vetë punonjësit e ndërmarrjes. Tani, për këtë mund të vijë një ditë drejtori i shërbimeve publike dhe t'ju bëjë një performancë të asaj ndërmarrje që ta shikoni se ku është kosto-përfitimi, ku janë të mirat e ndërmarrjeve të shërbimeve në varësi të bashkisë. Pra, nuk ka rritje aspak në lidhje me shërbimet online që ju



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

thoni. Bashkia nuk parashikon shpenzime për shërbimet online, asnjë shpenzim për shërbimet online.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka. E hedhim në votim. 21-Pro; 1-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Alfred Halilaj Këshilltar merr fjalën: -A mund ta bëj një shpjegim të votes kundër , të lutem?

Kr. Hysen Koldashi: Po , patjetër.

Alfred Halilaj Këshilltar merr fjalën: Në momentet kur jemi drejt countdown-it për ta mbaruar mandatin, ligji duhet t'ia heqë të drejtën Kryetarit të Bashkisë të shpenzojë fonde dhe prandaj unë jo vetëm që nuk e miratoj, por mezi po pres që buxhete të tilla të mos kemi për të miratuar.

Kr. Hysen Koldashi: Po, faleminderit. Një shpjegim të shkurtër, qeveria shqiptare bashkë me Bashkinë Kamëz, do të marrin e një tjetër mandat për të qeverisur Shqipërinë dhe për të çuar në 2030-tën në Bashkimin Evropian. Kurse ju, z. Halili, më vjen keq, por kam frikë se do të prisni shumë gjatë dhe s'do t'i arrini asnjëherë që të merrni drejtimin e Bashkisë Kamëz. Kur them z. Halili, s'kam gjë me ju personalisht, por si përfaqësues i grupit dhe faleminderit për shpjegimin e votës.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës nr.42, datë 19.06.2026, për: "Miratimin e programit të transparencës së Bashkisë së Kamëz. Kemi edhe përfaqësuesin e drejtorisë këtu, po do të thosha dy fjali, nëse jeni dakord, nëse jo, pastaj do bëj një pyetje konkrete. Transparenca është që nga momenti që mbledhjet e Këshillit Bashkiak bëhen live, jemi live, transmetojmë live në faqen e Këshillit Bashkiak. Besoj se më transparencë se kaq nuk ka, sepse bëhet gjithçka live dhe të gjithë projektvendimet dalin në faqen e Facebook-ut të Këshillit Bashkiak edhe shpërndahen, komentohen, bëhen, plus faktit nga tash shfaqen këdo. Unë e kam përsëritur disa herë se kush është këshilltar i vjetër, i di ca gjëra. Në asnjë mënyrë, të gjitha projektvendimet që ne i kalojmë me vendime me votën tonë shkojnë në prefekturë. Prefektura, nëse ka sadopak devijim nga baza ligjore, nga kushtetuta, ligji për qeverisjen vendore dhe rregullorja e Këshillit Bashkiak, në mënyrë kategorike i kthen mbrapsht dhe nuk i kalon. Gjithsesi, nëse ka kush pyetje konkrete për përfaqësuesin e dr. mund ta bëjë.

Alfred Halilaj Këshilltar merr fjalën: Tani me sa lexova unë këtë programin e transparencës, pyetja ime është konkrete: - A mendon që i plotësojmë të gjitha ato kriteret e përcaktuara në këtë program për transparencë?



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Florina Krrashi Sp.Dr.Medias: Përshëndetje. Unë di të them që ne i kemi të plotësuar të gjitha pikat dhe janë te modeli i transparencës në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjitha janë me link-e dhe të gjitha janë me informacione që të cilat dalin nga stafi i bashkisë, nga të gjitha drejtoritë që mbledhim informacionet dhe i publikojmë në web.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Këshilltar tjetër?

Largohet nga mbledhja anetaria e Këshillit Znj.Zelie Troci

Alfred Halilaj Këshilltar merr fjalën: Ti bëre një koment për veten, the që më transparencë se kaq nuk ka etj. Mirë që ata të projektit vendosën atë kamerën aty, sepse ju s'jeni transparent.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje ju lutem , jo komente.

Alfred Halilaj Këshilltar merr fjalën: Për shembull, një nga informacionet që duhet të qarkullojë online është, deklarimi i pasurisë së kryetarit të bashkisë. Është ai deklarimi i pasurisë online?

Kr. Hysen Koldashi: Përgjigjen do të ta jap unë sepse është jashtë pyetësorit. Pra, ata mund të shkojnë te ILKPD-ja, të interesohen .

Alfred Halilaj Këshilltar: Pyetja tjetër është Kryetari i Këshillit e ka atë CV-në dhe të gjitha këto gjëra dhe deklarimin e pasurisë aty? Janë të pasqyruara?

Kr. Hysen Koldashi: Kryetari i këshillit e jep përgjigjen vetë. Ashtu si jepet gjithë CV-ja e Kryetarit të Këshillit, ashtu edhe anëtarët e Këshillit Bashkiak janë te web-i, i faqes së Bashkisë Kamëz. Pyetja tjetër?

Alfred Halilaj Këshilltar : Pyetja tjetër është, - nëse një qytetar është i interesuar për një ankesë apo një kërkesë, sa kohë i merr informacioni për t'ia dhënë atë?

Kr. Hysen Koldashi: E jap përgjigjen unë. Sipas parashikimit ligjor që përcakton ligji për veçoritë e bashkisë.

Kr. Hysen Koldashi: Këshilltar, ka kush pyetje tjetër? Po shkurt, të lutem.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka. E hedhim në votim. 20-Pro; 1-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin nr. 40 dhe 18.06.2026 për: "Dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike".



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Kr. Hysen Koldashi: Ka kush pyetje nga këshilltarët? E hedhim në votim. 21-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Vazhdimi i mbledhjes nuk konsiderohet i ligjshëm për mungesë kourumi nga këshilltarët.

Kr. Hysen Koldashi , përshëndet të pranishmit.

SEKRETAR

Nexhmije TOPI

SHQIPËRI